Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 23 shkurt 2011

Lëndët me nr. 27/08, Esat BERISHA; 42/08, M.R.; 44/08, Ž.S.; 32/09, Slobodan AĆIMOVIĆ; 59/08, Tomo PETROVIĆ; 60/08, Obrad ĐOŠOVIĆ; 64/08, Dragan PETKOVIĆ; 67/08, Miodrag MILOSAVLJEVIĆ; 07/09, Čedo RALEVIĆ; 08/09, Miljko RALEVIĆ; 09/09, Dragomir RALEVIĆ; 10/09, Milenko RALEVIĆ; 11/09, Simo RALEVIĆ; 16/09 dhe 17/09 Muharem IBRAJ; 22/09 Musa IBRAJ; dhe 29/08 Milka ŽIVKOVIĆ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 23 shkurt 2011,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Znj. Anila PREMTI, Ushtruese detyre e zyrtarit ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesave të sipërpërmendura, të paraqitura në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve, gjen dhe rekomandon si vijon:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa e z. Berishës (lënda me nr. 27/08) u parashtrua më 18 korrik 2008 dhe u regjistrua në të njëjtën datë; ankesa e znj. M.R. (lënda me nr. 42/08) u parashtrua dhe u regjistrua më 27 tetor 2008; ankesa e znj. Ž.S. (lënda me nr. 44/08) u

parashtrua dhe u regjistrua më 28 tetor 2008; dhe ankesa e z. Aćimović (lënda me nr. 32/09) u parashtrua dhe u regjistrua më 27 shkurt 2009. Në procedurën pranë Panelit, z. Aćimović fillimisht përfaqësohej nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC). Mirëpo, DRC u tërhoq nga pjesëmarrja në procedurën pranë Panelit në dhjetor 2009.

2. Me vendimin e 6 gushtit 2010, Paneli i bashkoi këto katër ankesa dhe i shpalli ato të pranueshme pjesërisht.

3. Më 26 gusht 2010, PSSP-ja dha një përgjigje për vendimin e Panelit të datës 6 gusht 2010.

4. Ankesat e zotërinjve Petrović (lënda nr. 59/08), Đošović (lënda nr. 60/08), Petković (lënda nr. 64/08) dhe Milosavljević (lënda nr. 67/08) u parashtruan më 15 dhjetor 2008 dhe u regjistruan në të njëjtën ditë. Në procedurën pranë Panelit, këta ankues fillimisht u përfaqësuan nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC). Mirëpo, DRC u tërhoq nga përfaqësimi në procedurën pranë Panelit në dhjetor 2009. Ankesat e zotërinjve Ralević (lëndët me nr. 07/09, 08/09, 09/09, 10/09 dhe 11/09) u parashtruan dhe u regjistruan më 21 janar 2009, si dhe ankesat e zotërinjve Ibraj (16/09, 17/09 dhe 22/09).

5. Më 12 shtator 2009, Paneli, në pajtim me Rregullën 20 të Rregullores së vet të Punës, i bashkoi ankesat e zotërinjve Ralević. Në ditën e njëjtë, Paneli i bashkoi ankesat e zotërinjve Ibraj.

6. Me vendimin e 9 shtatorit 2010, Paneli i bashkoi ankesat në rastet e Petrović dhe të tjerët, Ralević dhe Ibraj dhe ato i shpalli të pranueshme pjesërisht.

7. Më 27 shtator 2010, PSSP-ja dha një përgjigje për vendimin e Panelit të datës 9 shtator 2010.

8. Ankesa e znj. Milka Živković (lënda nr. 29/08) u parashtrua më 18 korrik 2008 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

9. Me vendimin e datës 26 nëntor 2010, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme pjesërisht.

10. Më 6 janar 2011, PSSP-ja dha përgjigje për vendimin e Panelit të datës 26 nëntor 2010.

II. FAKTET

11. Të gjithë ankuesit, përveç z. Musa Ibraj i cili vdiq gjatë rrjedhës së procedurës pranë Panelit, janë banorë të Kosovës të cilët aktualisht jetojnë si persona të zhvendosur në Serbi. Ata kanë qenë pronar të pasurisë së paluajtshme në Kosovë. Ata jetuan këtu deri më 1999 kur u larguan nga Kosova. Më vonë ata kuptuan se prona e tyre ishte dëmtuar ose shkatërruar gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999.

12. Të gjithë ankuesit parashtruan ankesa në vitin 2004 duke kërkuar kompensim për dëmet e shkaktuara pasurisë së tyre në gjykatat kompetente kundër UNMIK-ut, KFOR-it, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ dhe komunave

relevante, me përjashtim të zotërinjve Petković, Milosavljević dhe M.R. të cilët ankesat e tyre i drejtuan vetëm kundër komunës dhe IPVQ-ve.

13. Në fund të vitit 2008 gjykatat nuk i kishin kontaktuar ankuesit dhe nuk ishin caktuar seanca dëgjimore.

14. Në vitin 2004 janë parashtruar rreth 17,000 kërkesa për kompensim pranë gjykatave të Kosovës, numri më i madh i të cilave nga serbët etnikë, të cilët për shkak të luftës i kishin braktisur shtëpitë e tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe prona e të cilëve më vonë ishte dëmtuar ose shkatërruar. Me qëllim të përmbushjes së afatit kohor prej pesë vitesh për paraqitjen e kërkesave civile për kompensim, këta ankues i paraqitën kërkesat e tyre rreth kohës së njëjtë në vitin 2004 pranë gjykatave të Kosovës. Kërkesat ishin drejtuar kundër UNMIK-ut, KFOR-it, dhe IPVQ-ve dhe kundër komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (më tutje në tekst HRAP), *Milogorić dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, mendim i 24 marsit 2010, § 1; për bazën ligjore në të cilën ankuesit e mbështetën kërkesën e tyre shih mendimin e njëjtë, § 5).

15. Lidhur me këto raste, Drejtori i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) u dërgoi një shkresë të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe atyre të qarkut dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës më 26 gusht 2004. Në këtë shkresë, drejtori i DD theksoi se ishin paraqitur "mbi 14,000" kërkesa të tilla. Ai iu referua "problemit që do të paraqiste një fluks kaq i madh i kërkesave për gjykatat", dhe kërkoi që "asnjë rast [i tillë] të mos caktohej derisa ne bashkërisht të vendosim se si më së miri të bëjmë shqyrtimin e këtyre rasteve " (për tekstin e plotë të shkresës, shih mendimin *Milogorić dhe të tjerët*, të cituar në § 14 lart, § 6).

16. Më 15 nëntor 2005, DD ju bëri thirrje gjykatave që të fillojnë shqyrtimin e kërkesave për dëmet e shkaktuara nga persona të identifikuar fizikë dhe për dëmin e shkaktuar pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar se më nuk ekzistonin "pengesat" për shqyrtimin efektiv të këtyre rasteve. Kërkesat që lidheshin me ngjarjet që ndodhën pas tetorit 2000 nuk prekeshin nga kjo shkresë.

17. Më 28 shtator 2008, Drejtoria e DD i udhëzoi gjykatat që për rastet për të cilat nuk ishte caktuar seancë sipas kërkesës së datës 26 gusht 2004 tani të procedohen.

18. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacionale nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

19. Rrethanat e rasteve individuale që janë në shqyrtim janë paraqitur në shtojcën e këtij opinioni.

III. ANKESAT

20. Përderisa ankesat janë shpallur të pranueshme, ankuesit në esencë ankohen se procedura lidhur me kërkesat e tyre për kompensimin e pasurisë së tyre të dëmtuar ishte pezulluar, duke e bërë të pamundur që ata të marrin një vendim për kërkesat e tyre, duke shkelur të drejtën e tyre për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ata gjithashtu ankohen se, si rezultat i pezullimit, procedura nuk është përfunduar brenda një periudhe kohore të arsyeshme, duke shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ. Më në fund, me përjashtim të rastit me nr. 29/08, Milka Živković, ata pretendojnë se për arsyen e njëjtë, e drejta e tyre për mjet efikas juridik sipas nenit 13 të KEDNJ është shkelur po ashtu.

IV. BASHKIMI I ANKESAVE

21. Në pajtim me Rregullën 20 të Rregullores së vet të punës, Paneli vendosi të bashkojë këto ankesa.

V. LIGJI

Shkeljet e pohuara të nenit 6 § 1 të KEDNJ

22. Paneli thekson se rasti i ankuesve ngrit një çështje esenca e së cilës tanimë është parashtruar pranë Panelit nga ankues të tjerë. Paneli përkujton se në rastet e bashkuara p. sh. të *Milogorić dhe të tjerët* (cituar në § 14 lart), shqyrtoi ankesa nga pesë ankues të cilët gjithashtu ishin pronarë të pasurisë së paluajtshme në Kosovë. Në vitin 1999, duke u frikësuar nga lufta, ata po ashtu i lëshuan shtëpitë e tyre në Kosovë. Pasuria e tyre ishte dëmtuar apo shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999, pas hyrjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë. Këta ankues gjithashtu paraqitën ankesa në vitin 2004 pranë gjykatave kompetente komunale kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunave përkatëse, duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar pasurisë së tyre. Ata po ashtu nuk ishin kontaktuar nga gjykatat dhe nuk ishin caktuar seanca dëgjimore, për shkak të ndërhyrjes së përmendur lart nga DD që ndaloi procedurat gjyqësore nga gushti i vitit 2004 deri në shtator 2008.

23. Në rastin *Milogorić*, Paneli konstatoi se "fakti se për një periudhë të gjatë kohore ankuesve u ishte parandaluar marrja e vendimit për kërkesat e tyre për kompensim nga gjykatat si pasojë e ndërhyrjes së DD, përbënte shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ", në mënyrë më specifike të së drejtë së tyre për qasje në gjykatë (HRAP, *Milogorić dhe të tjerët*, cituar lart, § 46). Paneli po ashtu konstatoi se "nuk ishte e nevojshme të shqyrtohet ndaras çështja e kohëzgjatjes së procedurës" (mendim i njëjtë, § 48).

24. Në përgjigjen e tij të datës 26 gusht 2010 për lëndët me nr. 27/08, Esat Beriša dhe të tjerët, dhe 27 shtator 2010 në lëndët me nr. 59/08, Tomo Petrović dhe të tjerët, PSSP-ja tha se ai nuk kishte komente për bazueshmërinë e rasteve. Mirëpo, ai kërkon që Paneli të rishqyrtojë konstatimet e tij të mëhershme duke pasur parasysh faktin se nga UNMIK-u, si administratë e përkohshme, nuk mund të kërkohen standardet e njëjta sikurse nga një shtet i krijuar me gjyqësor funksional.

Në përgjigjen e tij të 6 janarit 2011 në rastin nr. 29/08, Milka Živković, PSSP-ja ofroi argumente të detajuara, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). PSSP-ja në mes tjerash argumenton se kërkesa e UNMIK-ut që të pezullohet procedura duhet të konsiderohet se ka pasur një qëllim legjitim, dhe se në rrethanat e pas luftës në Kosovë dhe sistemin e saj të mugulluar gjyqësor, pezullimi i përkohshëm ishte mënyra e vetme për UNMIK-un që ta trajtojë situatën e jashtëzakonshme me të cilën përballej sistemi gjyqësor i Kosovës, të shkaktuar nga fluksi i kërkesave për kompensim. PSSP-ja gjithashtu argumenton se ka pasur një përpjesëtim të arsyeshëm në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohej të arrihej, sepse ishte bërë një balancë e drejtë në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe kushteve për mbrojtjen e të drejtave fundamentale të njeriut. Sipas PSSP-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në frymën e rrethanave të veçanta të rastit, dhe GJEDNJ zbaton veçanërisht tri kritere: sjelljen e autoriteteve gjyqësore, ndërlikuehmërinë e rastit dhe sjelljen e kërkuesit. Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit përbëjnë shkelje të kushtit për kohë të arsyeshme. PSSP-ja më pastaj analizon në detaje zbatimin e tri kritereve të lartshënuara në kontekstin e Kosovës, dhe ashtu si ata ndërlidhen me ankesën.

25. Paneli përkujton se veç ka marrë parasysh argumente të ngjashme në *Milogorić* dhe nuk u pajtua. Paneli konstatoi se qëndron fakti se karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet të merren parasysh për sa u përket disa situatave, por nën asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat janë përfshirë në mandatin e UNMIK-ut (mendimi i njëjtë, § 44).

26. Prandaj Paneli nuk sheh arsye t'ju shmanget konstatimeve në lëndët e bashkuara të rastit *Milogorić dhe të tjerët*.

27. Në përputhje me këtë, Paneli konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ lidhur me pamundësinë e ankuesve që të marrin një vendim nga gjyqi për kërkesat e tyre, dhe se nuk ka nevojë të shqyrtojë ndarazi çështjen e kohëzgjatjes së procedurës.

Shkelja e pohuar e nenit 13 të KEDNJ

28. Paneli konstaton se sipas nenit 13 të KEDNJ (e drejta për mjet juridik efektiv) kemi të bëjmë në esencë me çështjet e njëjta sikurse ato të diskutuara sipas nenit 6 § 1. Në këto rrethana, Paneli konstaton se nuk kemi çështje të veçanta që janë paraqitur sipas nenit 13 të KEDNJ (HRAP, *Milogorić dhe të tjerët*, cituar lart, § 49).

V. REKOMANDIMET

29. Duke marrë parasysh konstatimet e Panelit në këtë rast, Paneli është i mendimit se ndonjë formë e reparacionit është e nevojshme.

30. UNMIK-u natyrisht duhet të merr masat e duhura për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar dhe për të sanuar sa më shumë që është e mundur efektet nga këto pasoja. Mirëpo, siç konstatoi Paneli më lart, përgjegjësia e UNMIK-ut për sa i përket gjyqësorit në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, kur EULEX-i mori tërë kontrollin operacionale në fushën e sundimit të ligjit. Prandaj UNMIK-u nuk është

më në pozicion të merr masa të cilat do të kishin efekt të drejtpërdrejtë në procedurat që presin shqyrtim pranë gjykatave komunale.

31. Paneli konstaton se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimet e tij për të sanuar sa më shumë që është e mundur efektet e shkeljes për të cilën është përgjegjës. Në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ në situatat e juridiksionit të zvogëluar të shtetit, Paneli është i mendimit se UNMIK-u duhet të bëjë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion *vis-à-vis* autoriteteve të Kosovës, për të marrë garancinë se lëndët e paraqitura nga ankuesit do të procedohen si duhet (shih HRAP, *Milogorić dhe të tjerët*, cituar lart, § 49, dhe krahaso GJEDNJ (grand chamber), *Ilaşcu dhe të tjerët v. Moldavia dhe Rusia*, nr. 48787/99, aktgjykim i 8 korrikut 2004, KEDNJ, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mfudhi v. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, aktgjykim i 2 marsit 2010, § 171).

32. Paneli gjithashtu konsideron se UNMIK-u duhet të ndërmerr hapa për kompensim adekuat për secilin ankues, për dëme jomateriale të shkaktuara si pasojë e pezullimit të prolonguar të procedurës së iniciuar nga ata.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SA I PËRKET PAMUNDËSISË SË ANKUESVE QË TË MARRIN VENDIM PËR KËRKESAT E TYRE NGA GJYKATAT;

2. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOJË ANKESAT SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT LIDHUR ME KOHËZGJATJEN E PROCEDURËS;

3. KONSTATON SE NUK KA NEVOJË TË SHQYRTOJË ANKESAT SIPAS NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

4. REKOMANDON QË UNMIK-U:

a. TË NXISË AUTORITETET KOMPETENTE NË KOSOVË TË NDËRMARRIN TË GJITHA HAPAT E MUNDSHËM PËR TË SIGURUAR QË RASTET E ANKUESVE TË VENDOSEN PA VONESA TË MËTEJSHME;

b. TË NDËRMARRIN HAPA ADEKUAT PËR KOMPENSIM TË DUHUR PËR SECILIN ANKUES PËR DËMET JOMONETARE;

c. TË NDËRMARRIN MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIT DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME TË RASTIT.

Anila PREMTI	Marek NOWICKI
Ushtruese detyre e zyrtares ekzekutive	Kryetar

Shtojcë

Lënda nr. 27/08, Esat Beriša

1. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

2. Ai është pronar i dy shtëpive të banimit që ndodhen në Graçanicë, ku ai jetoi deri në gusht 1999. Ai ishte njoftuar nga fqinjët se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

3. Në gusht 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë kundër komunës së Prishtinës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it duke kërkuar kompensim për dëmtimin e pasurisë së tij. Ai kërkon 220,000 euro kompensim të këtij dëmi.

4. Në fund të vitit 2008, gjykata e qarkut nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 42/08, M.R.

5. Ankuesja është banore e Kosovës e cila aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

6. Ankuesja është pronare e një shtëpie banimi që ndodhet në komunën e Istogut, ku ajo jetoi deri në qershor 1999. Ajo ishte njoftuar nga fqinjët se prona e saj ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

7. Më 10 qershor 2004 ankuesja parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Istok kundër komunës së Istogut dhe IPVQ-ve, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pronës së saj. Ajo kërkon 158,000 euro për kompensim të këtij dëmi.

8. Në fund të vitit 2008 gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesen dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 44/08, Ž.S.

9. Ankuesja është banore e Kosovës e cila aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

10. Ajo është pronare e një shtëpie banimi që ndodhet në Prizren ku ajo jetoi deri në qershor të vitit 1999. Ajo ishte njoftuar nga miqtë se pasuria e saj ishte dëmtuar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

11. Më 3 shtator 2004 ankuesja parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Prizren kundër komunës së Prizrenit, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pronës së saj. Ajo kërkon 82,000 euro për kompensim të këtij dëmi.

12. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesen dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 32/09, Slobodan Aćimović

13. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

14. Ai është pronar i një shtëpi banimi që ndodhet në komunën e Ferizajt ku ai dhe familja e tij kanë jetuar deri në qershor 1999. Ai ishte njoftuar nga një mik se shtëpia ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

15. Më 24 gusht 2004 ankuesi parashtro padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Ferizaj kundër komunës së Ferizajt, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 143,000 euro kompensim të këtij dëmi.

16. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 59/08, Tomo Petrović

17. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

18. Ai është pronar i një dhome rimorkioje që ndodhej në komunën e Pejës, ku ai jetoi deri në qershor 1999. Ai ishte njoftuar nga fqinjët e tij se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

19. Në qershor 2004 ankuesi parashtro padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Pejë kundër komunës së Pejës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 42,000 euro kompensim të këtij dëmi.

20. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 60/08, Obrad Đošović

21. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

22. Ankuesi është pronar i një banese që ndodhet në komunën e Pejës ku ai jetoi deri në qershor të vitit 1999. Ai ishte njoftuar nga fqinjët e tij se banesa ishte uzurpuar dhe pasuria e tij ishte shkatërruar dhe vjedhur gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

23. Në qershor 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Pejë kundër komunës së Pejës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pasurisë së tij. Ai kërkon 151,000 euro kompensim të këtij dëmi.

24. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 64/08, Dragan Petković

25. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

26. Ai është pronar i një shtëpi banimi që ndodhet në Ferizaj ku ai jetoi deri në qershor 1999. Ai është njoftuar nga fqinjët se pasuria e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

27. Në qershor 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Ferizaj kundër komunës së Ferizajt dhe IPVQ-ve, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pasurisë së tij. Ai kërkon 510,000 euro kompensim të këtij dëmi.

28. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 67/08, Miodrag Milosavljević

29. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

30. Ankuesi është pronar i tri shtëpive që ndodhen në komunën e Istogut, ku ai jetoi deri në qershor 1999. Ai është njoftuar nga fqinjët se banesa e tij ishte uzurpuar dhe pasuria e tij ishte shkatërruar dhe vjedhur gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

31. Në qershor 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Istog kundër komunës së Istogut dhe IPVQ-ve, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pasurisë së tij. Ai kërkon 87,000 euro kompensim të këtij dëmi.

32. Në fund të vitit 2008, gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 07/09, Čedo Ralević

33. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

34. Ai është pronar i një shtëpi banimi që ndodhet në komunën e Pejës ku ai jetoi deri në qershor 1999. Ai është njoftuar nga fqinjët se pasuria e tij është shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

35. Në qershor 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë kundër komunës së Pejës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, duke kërkuar kompensim për shkatërrimin e pasurisë së tij. Ai kërkon 370,000 euro kompensim të këtij dëmi.

36. Në fund të vitit 2008, gjykata e qarkut nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 08/09, Miljko Ralević

37. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

38. Ai është pronar i një shtëpie banimi që ndodhet në komunën e Pejës ku ai jetoi deri në qershor 1999. Ai është njoftuar nga fqinjët se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

39. Në qershor 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë kundër komunës së Pejës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it duke kërkuar kompensim për dëmtimin e pronës së tij. Ai kërkon 650,000 euro kompensim të këtij dëmi.

40. Në fund të vitit 2008, gjykata e qarkut nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 09/09, Dragomir Ralević

41. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

42. Ai është pronar i një shtëpie banimi që ndodhet në komunën e Pejës ku ai jetoi deri në qershor të vitit 1999. Ai ishte njoftuar nga fqinjët se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

43. Më 5 nëntor 2004 ankuesi parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës komunale në Pejë kundër komunës së Pejës dhe IPVQ-ve, duke kërkuar kompensim për dëmtimin e pronës së tij. Ai kërkon 600,000 euro kompensim të këtij dëmi.

44. Në fund të vitit 2008 gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 10/09, Milenko Ralević

45. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

46. Ai është pronar i një shtëpie banimi që ndodhet në komunën e Pejës ku ai jetoi deri në qershor të vitit 1999. Ai është njoftuar nga fqinjët se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

47. Më 5 nëntor 2004 ankuesi parashtro padi për kompensim pranë gjykatës komunale të Pejës kundër komunës së Pejës dhe IPVQ-ve duke kërkuar kompensim për dëmin e shkaktuar pronës së tij. Ai kërkon 200,000 euro kompensim të këtij dëmi.

48. Në fund të vitit 2008 gjykata komunale nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk kishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 11/09, Simo Ralević

49. Ankuesi është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

50. Ai është pronar i një shtëpie banimi që ndodhet në komunën e Pejës ku ai jetoi deri në qershor 1999. Ai është njoftuar nga fqinjët se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

51. Në qershor të vitit 2004 ankuesi parashtro padi për kompensim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë kundër komunës së Pejës, IPVQ-ve dhe UNMIK-ut e KFOR-it duke kërkuar kompensim për dëmtimin e pronës së tij. Ai kërkon 1,340,000 euro kompensim të këtij dëmi.

52. Në fund të vitit 2008, gjykata e qarkut nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lëndët me nr. 16/09 dhe 17/09, Muharem Ibraj; Lënda nr. 22/09, Musa Ibraj

53. Ankuesi Muharem Ibraj është banor i Kosovës i cili aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi. Në procedurën pranë Panelit ai gjithashtu përfaqëson të atin e tij të ndjerë Musa, i cili vdiq në prill të vitit 2009.

54. Zotërinjtë Ibraj janë pronarë të shtëpive të banimit në komunën e Gjakovës ku ata jetuan deri në qershor 1999. Ata ishin njoftuar nga fqinjët se prona e tyre ishte shkatërruar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

55. Gjatë vitit 2004 ankuesit parashtruan tri padi të ndryshme për kompensim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë kundër komunës së Gjakovës, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it duke kërkuar kompensim për dëmtimin e pronës së tyre. Ata kërkojnë një shumë të përgjithshme prej 416,000 euro kompensim të këtij dëmi.

56. Në fund të vitit 2008, gjykata e qarkut nuk i kishte kontaktuar ankuesit dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.

Lënda nr. 29/08, Milka Živković

57. Ankuesja është banore e Kosovës e cila aktualisht jeton si person i zhvendosur në Serbi.

58. Ajo është pronare e një banese dhe pasurisë së luajtshme që ndodhet në Prishtinë, ku ajo jetoi deri në gusht 1999. Në vitin 2002, ajo kuptoi se banesa e saj dhe gjësendet përbrenda ishin dëmtuar shumë.

59. Në qershor të vitit 2004 ankuesja parashtroi padi për kompensim pranë gjykatës së qarkut në Prishtinë kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunës së Prishtinës, duke kërkuar kompensim për dëmtimin e pronës së saj. Ajo kërkon 22,000 euro kompensim të këtij dëmi.

60. Në fund të vitit 2008 gjykata e qarkut nuk e kishte kontaktuar ankuesen dhe nuk ishte caktuar seancë dëgjimore.